

Kodi i Sjelljes i Statkraftit

Përmbajtja

Mesazh nga CEO..... 3

**Pjesa I: Kuptimi dhe
zbatimi i Kodit të Sjelljes**

1. Përkushtimi i Statkraftit..... 4

2. Fusha e zbatimit..... 4

3. Përgjegjësia personale..... 5

4. Përgjegjësia menaxheriale..... 5

5. Përmirësim i vazhdueshëm..... 5

**Pjesa II: Veprimi në mënyrë
të përgjegjshme**

1. Shëndeti, parrezikshmëria
dhe siguria..... 6

2. Të drejtat e njeriut..... 7

3. Mjedisi, klima dhe
ekonomia rrethore..... 8

4. Etika e biznesit..... 9

5. Njerëzit dhe organizimi..... 11

**Pjesa III: Trajtimi i rasteve të
dyshimeve dhe shkeljeve të rregullave**

1. Ku të kërkonti këshilla..... 13

2. Ku të raportoni shqetësime
ose shkelje të rregullave..... 13

3. Pasojat e shkeljes..... 14

Mesazh nga CEO

Përkushtimi ynë kryesor për të vepruar në mënyrë të përgjegjshme përshkruhet në Kodin e Sjelljes, i cili përcakton pritshmëritë ndaj punonjësve të Statkraftit si dhe ndaj partnerëve tanë të biznesit.

Sjellja e qëndrueshme dhe e përgjegjshme e biznesit ka qenë gjithnjë dhe vazhdon të jetë një shtyllë për Statkraftin në të gjitha tregjet ku jemi të pranishëm. Duke ofruar energji të pastër, kontribuojmë ndjeshëm në trajtimin e sfidave të shkaktuara nga ndryshimi i klimës dhe në krijimin e një baze për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Jam i bindur se vlerat tona – veprojme në mënyrë të përgjegjshme, rritemi së bashku dhe kemi ndikim – së bashku me këtë Kod të Sjelljes tregojnë se jemi të pozicionuar mirë për të kryer detyrën tonë. Sjellja e qëndrueshme dhe e përgjegjshme e biznesit ndërton besim dhe besnikëri mes punonjësve, partnerëve të biznesit, klientëve dhe komuniteteve. Në këtë mënyrë, do të vazhdojmë të jemi partneri i tyre i preferuar.

Kujdesi për njerëzit është në qendër të kulturës së kompanisë sonë dhe të gjithë duhet të kthehen në shtëpi të sigurt nga puna në Statkraft. Besoj se kjo është e mundur nëse të gjithë ata që punojnë për Statkraftin janë të përkushtuar ndaj sigurisë dhe përgjegjësisë, duke filluar nga unë, marrin një përgjegjësi të veçantë për të dhënë shembullin e tyre në këtë fushë.

Sjellja e përgjegjshme në punë ka të bëjë gjithashtu me qëndrueshmërinë, duke përfshirë respektimin e të drejtave të njeriut e të punës dhe kujdesin për mjedisin e klimën. Pres që përgjegjësit të tregojnë përkushtim dhe të vendosin tonin për kulturën e kompanisë sonë. Gjithashtu inkurajoj të gjithë të kenë diskutime aktive dhe të hapura për sfidat që shfaqen.

U japim mbështetjen tonë të plotë punonjësve që ngrenë shqetësime. Përmeshja e Kodit tonë të Sjelljes në praktikë varet nga secili prej nesh, kudo në botë, çdo ditë.

Ky version i Kodit të Sjelljes i Statkraft është miratuar nga Bordi i Drejtoreve në datën 11.12.2023.

Kuptimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes

Veprimi në mënyrë të përgjegjshme

Handling cases of doubt and breaches of the rules

Pjesa I: Kuptimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes

1. Përkushtimi i Statkraftit

Statkrafti përkushtohet të veprojë në mënyrë të qëndrueshme, etike, të sigurt e të përgjegjshme dhe që pajtohet me të gjitha kërkesat ligjore në fuqi kudo ku operon. Është gjithashtu politikë e Statkraftit që të veprojë në përputhje me konventat, kornizat dhe udhëzimet përkatëse ndërkombëtare të përcaktuara nga organizata ndërkombëtare¹.

Statkrafti bën biznes në nivel global. Si një entitet norvegjez, Statkrafti pajtohet me ligjet e rregulloret norvegjeze në fuqi, si dhe me ligjet e rregulloret në fuqi të shteteve në të cilat operojmë.

Kur ekzistojnë dallime ndërmjet ligjeve, rregulloreve dhe politikave të Statkraftit në fuqi, ne ndjekim standardin më të lartë.

Parimet që përmbahen në Kodin e Sjelljes përfaqësojnë një përmbledhje të pjesëve përkatëse të dokumenteve qeverisëse të Statkraft.

2. Fusha e zbatimit

Kodi i Sjelljes zbatohet për të gjitha kompanitë në Grupin Statkraft dhe për të gjithë individët që punojnë për Statkraftin, pavarësisht nga vendndodhja. Kjo përfshin punonjësit e të gjitha niveleve, anëtarët e bordit, personelin e punësuar, konsulentët dhe të tjerë që veprojnë në emër ose përfaqësojnë Statkraftin.

Statkrafti nuk mund të arrijë qëllimet e tij të biznesit pa partnerë në sipërmarrje të përbashkëta, furnitorë, kontraktorë, agjentë, konsulentë, palë në bashkime dhe blerje ose klientë. Partnerët e biznesit priten të respektojnë standardet që janë në përputhje me kërkesat e Statkraftit.

¹ Duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në udhëzime dhe kuadro Kombet e Bashkuara (OKB), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE). Statkraft është gjithashtu një anëtar i Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara.

Kuptimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes

Veprimi në mënyrë të përgjegjshme
Handling cases of doubt and breaches of the rules

3. Përgjegjësia personale

Duhet të sigurohemi që jemi njohur me dhe kryejmë detyrat tona në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Sjelljes dhe ligjet e rregulloret në fuqi. Nëse nuk jemi të sigurt për kuptimin e ndonjë pjese të Kodit të Sjelljes ose përballemi me një dilemë etike, kërkojmë këshilla dhe e diskutojmë këtë me përgjegjësin tonë.

4. Përgjegjësia menaxheriale

Përgjegjësitet pritet të tregojnë përkushtim dhe të vendosin tonin për kulturën e kompanisë sonë. Ata duhet të sigurohen se veprimtaritë brenda fushës së tyre të përgjegjësisë kryhen në përputhje me kërkesat në fuqi dhe Kodin e Sjelljes. Përgjegjësitet janë përgjegjës për sjelljen e tyre të biznesit, si dhe për atë të personelit të tyre.

5. Përmirësim i vazhdueshëm

Përqendrohemi vazhdimisht në përmirësimin dhe novacionin. Menaxhimi aktiv i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm janë pjesë përbërëse të të gjitha veprimtarive të biznesit.

Kuptimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes

Veprimi në mënyrë të përgjegjshme

Handling cases of doubt and breaches of the rules

Pjesa II: Veprimi në mënyrë të përgjegjshme

1. Shëndeti, parrezikshmëria dhe siguria

Përkushtimi ynë

Jemi të përkushtuar ndaj një vendi pune të sigurt dhe të shëndetshëm pa lëndime ose dëmtime. Kujdesemi për veten dhe të gjithë njerëzit me të cilët punojmë dhe se si veprimtaritë tona ndikojnë në sigurinë e të tjerëve. Mësojmë nga puna jonë e përditshme dhe nga të tjerët, guxojmë të shprehemi kur është e nevojshme dhe japim mësimë anembanë organizatës dhe mësojmë prej tyre.

- **Shëndeti, parrezikshmëria dhe siguria**

Kujdesi për njerëzit është në qendër të kulturës së Statkraftit. Një mjedis i parrezikshëm, i sigurt dhe i shëndetshëm është parësor dhe kjo zbatohet kudo që jemi. Punojmë vazhdimisht për të përmirësuar performancën tonë drejt zero dëmtime të rënda.

- **Substancat intoksikuese**

Gjatë kohës që punojmë për Statkraftin, nuk lejohet të jemi nën ndikimin e substancave intoksikuese, përfshirë alkoolin dhe drogën. Sasi të kufizuara alkooli mund të shërbehen kur zakoni vendas dhe rasti e bëjnë këtë të përshtatshme, me kusht që konsumimi të mos kombinohet me përdorimin e makinerive, drejtimin e automjetit ose ndonjë veprimtari tjetër që është e papajtueshëm me përdorimin e alkoolit.

2. Të drejtat e njeriut

Përkushtimi ynë

Jemi të përkushtuar të respektojmë të drejtat e njeriut të njerëzve tanë, punëtorëve të zinxhirit tonë të furnizimit dhe komuniteteve të ndikuara nga veprimtaria jonë, duke parandaluar, minimizuar dhe zbutur ndikimet negative. Do të angazhohemi vetëm me partnerë të biznesit që janë të përkushtuar ndaj respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë zinxhirët e tyre të furnizimit. Jemi të përkushtuar të ofrojmë ose të bashkëpunojmë në procese korrigjimi atje ku veprimtaritë tona shkaktojnë ose kontribuojnë në ndikime negative në të drejtat e njeriut.

- **Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e punës**

Respektojmë të drejtat e njeriut dhe të punës, përfshirë lirinë e organizimit dhe të drejtën për marrëveshje kolektive, eliminimin e të gjitha formave të punës së detyruar dhe të detyrueshme, heqjen efektive të punës së fëmijëve dhe eliminimin e diskriminimit lidhur me punësimin dhe profesionin.

Jemi të përkushtuar ndaj kushteve të mira të punës, përfshirë orët e punës në përputhje me kufijtë e rekomanduar të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) dhe pagimin e një page jetese për punonjësit tanë. Presim që kontraktorët tanë të zbatojnë të njëjtën gjë për personelin që punon në vendet tona të punës. Zbritja nga paga është e papranueshme si masë disiplinore dhe askujt nuk duhet t'i kërkohej të paguajë për t'u angazhuar nga Statkraft (p.sh. tarifa të rekrutimit ose kompensime të tjera).

- **Të drejtat sociale dhe të komunitetit**

Respektojmë të drejtat e njerëzve të prekur nga veprimtaritë tona, përfshirë grupet indigjene, fisnore dhe grupe të tjera të cenueshme. Përpiqemi të sigurojmë konsultime dhe pjesëmarrje të informuar me njerëzit e prekur në përputhje me kornizat ndërkombëtare dhe të kemi mekanizmat e duhur të ankesave.

Kuptimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes

Veprimi në mënyrë të përgjegjshme

Handling cases of doubt and breaches of the rules

3. Mjedisi, klima dhe ekonomia rrethore

Përkushtimi ynë

Ambicia jonë e përgjithshme është të mbështesim një tranzicion të gjelbër dhe të drejtë të energjisë. E bëjmë këtë duke zhvilluar një zinxhir të vlerës neto zero, duke u rritur brenda kufijve planetarë dhe duke adoptuar mënyra rrethore të të menduarit. Kërkojmë të balancojmë me kujdes konsideratat mjedisore, të klimës dhe shoqërore.

- **Mjedisi**

Punojmë për të pakësuar ndikimin tonë mbi mjedisin dhe për të mbështetur një metodë parandaluese, përfshirë vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut. Ndërmarrim nisma për të promovuar përgjegjësi më të madhe mjedisore dhe për të inkurajuar zhvillimin dhe përhapjen e teknologjive miqësore ndaj mjedisit.

- **Klima**

Përmes veprimtarive kontribuojmë në kalimin në një sistem energjie më miqësor ndaj klimës dhe të qëndrueshëm. Përpiqemi të ruajmë një gjurmë të ulët të klimës dhe të pakësojmë emetimet tona të gazeve serra.

- **Ekonomia rrethore**

Përpiqemi të zbatojmë një mentalitet të ekonomisë rrethore, duke përfshirë adoptimin e një perspektive të ciklit jetësor dhe promovimin e efikasitetit, ripërdorimit dhe riciklimit të burimeve.

4. Etika e biznesit

Përkushtimi ynë

Kemi tolerancë zero ndaj korrupsionit dhe krimeve ekonomike të tjera në të gjitha format e tyre dhe nuk bëjmë kompromis mbi këtë angazhim pavarësisht nga synimet tregtare. Do të sigurohemi se kemi kompetencën për të operuar me kujdes në mjediset sfiduese të biznesit dhe për të trajtuar shqetësimet. Të gjithë do të kërkojmë këshilla nëse kemi dyshime. Angazhojmë vetëm ata partnerë të biznesit që përmbushin standarde të pranueshme ose kanë një plan të besueshëm përmirësimi.

- **Antikorrupsioni**

Kundërshtojmë të gjitha format e korrupsionit dhe dhënies së ryshfetit, në të gjitha format e tij në sektorin publik dhe privat. Nuk ofrojmë, japim, pranojmë, kërkojmë ose marrim ryshfet ose avantazhe të tjera të padrejta, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, për përfitime biznesi ose private, qoftë për veten ose për të tjerë.

- **Dhuratat dhe mikpritja**

Japim dhe marrim vetëm dhurata dhe mikpritje që janë modeste dhe të përshtatshme. Ndalohet ofrimi ose pranimi i mirësjelljeve të biznesit – dhurata, mikpritje, shpenzime ose ndonjë përfitim – kur mund të përbëjnë, ose duket se përbëjnë një ndikim të padrejtë. Përveç kësaj, mirësjelljet e biznesit mund të pranohen ose ofrohen vetëm nëse janë modeste, si në lidhje me vlerën ashtu edhe shpeshësinë, dhe nëse koha e vendi janë të përshtatshme.

- **Zyrtarët publikë, entitetet dhe palët e tjera të interesuara**

Jemi të kujdesshëm kur kemi të bëjmë me zyrtarët publikë, entitetet dhe palët e tjera të interesuara. Ushtrojmë kujdes të shtuar kur mirësjelljet e biznesit përfshijnë zyrtarë publikë.

Statkrafti nuk sponsorizon parti politike ose politikanë. Statkrafti mund të marrë pjesë në debata publikë kur është në interes të Grupit. Të gjithë ata që punojnë për, veprojnë në emër të ose përfaqësojnë Statkraftin janë të lirë të marrin pjesë në veprimtari politike demokratike, por kjo duhet të jetë pa referim ose pa lidhje me marrëdhëniet e tyre me Statkraftin.

Kuptimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes

Veprimi në mënyrë të përgjegjshme

Handling cases of doubt and breaches of the rules

- **Konflikti i interesit dhe konkurrenca e drejtë**

Shmangim konfliktet e interesit dhe sigurojmë konkurrencë të drejtë. Shmangim situatat që shkaktjnë konflikt ndërmjet interesit individual, privat dhe interesit të Statkraftit, ose që në çfarëdo mënyre mund të kenë një ndikim negativ në lirinë tonë të veprimit ose gjykimit.

Zbatojmë standarde të larta etike tregtare dhe konkurrojmë brenda kuadrit të rregullave të konkurrencës në tregjet në të cilat vepron Statkrafti. Kjo zbatohet lidhur me konkurrentët dhe furnitorët, si dhe me klientët.

- **Partnerët e biznesit dhe procesi i përputhshmërisë së integritetit**

E dimë se me kë bëjmë biznes dhe shmangim partnerët jo etike të biznesit. Marrëveshjet me partnerët e biznesit duhet të bëhen me shkrim dhe të përshkruajnë marrëdhënien e vërtetë ndërmjet palëve. Kompensimet e rëna dakord duhet të jenë në përpjesëtim me shërbimin e kryer, të bëra kundrejt një dokumentacioni të kënaqshëm dhe të llogaritura siç duhet.

Nuk kemi biznes ose marrëdhënie me një shtet , grup, organizatë apo individ të sanksionuar.

- **Mashtrimi**

Kujdesemi për të parandaluar të gjitha format e mashtimit dhe punojmë vazhdimisht për të forcuar veprimtaritë tona parandaluese. Nuk marrim pjesë në asnjë formë të pastrimit të parave dhe sigurohemi që veprimet financiare në të cilat është pjesë Statkrafti nuk përdoren për pastrimin e parave.

- **Konfidencialiteti dhe trajtimi i informacionit**

Sigurojmë konfidencialitetin dhe trajtimin e duhur të informacionit. Jemi të përkushtuar ndaj transparencës, verifikueshmërisë dhe saktësisë në të gjitha marrëdhëniet tona, ndërsa respektojmë detyrimet tona të konfidencialitetit. Ofrojmë informacion për dhe komunikojmë me të gjitha palët e interesuara në mënyrë të hapur, të saktë dhe në kohën e duhur. I gjithë informacioni dhe raportimi i kontabilitetit duhet të jetë i saktë dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret.

Jemi të përkushtuar të ruajmë të gjithë dhe të mos keqpërdorim asnjë informacion konfidencial në posedimin tonë, qoftë informacion që i përket Statkraftit ose partnerëve të biznesit. Detyra e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi marrëdhënia jonë e punësimit ose një marrëdhënie tjetër kontraktuale me Statkraftin ka përfunduar.

Jemi të përkushtuar të mbrojmë të drejtën e individëve për privatësi. Sigurohemi se përpunojmë të dhënat personale të individëve, qofshin punonjësit tanë ose ndonjë palë tjetër e tretë, me përgjegjësi dhe sigurohemi se kemi një qëllim përkatës për të gjitha rastet kur kërkohet përpunimi i të dhënave personale. Jemi të detyruar nga Rregullat Detyruese të Korporatës të Statkraft (Statkraft's Binding Corporate Rules), të cilat rregullojnë përpunimin dhe transferimin në mbarë kompaninë e të dhënave personale të punonjësve dhe të palëve të treta.

5. Njerëzit dhe organizimi

Përkushtimi ynë

Jemi të përkushtuar ndaj një përvoje të shkëlqyer dhe gjithëpërfshirëse të punonjësve. Kemi një kulturë ku veprojmë në mënyrë të përgjegjshme, rritemi së bashku dhe kemi ndikim.

- **Barazia, shumëllojshmëria dhe gjithëpërfshirja**

Punojmë në mënyrë aktive për të krijuar një mjedis pune gjithëpërfshirës ku shumëllojshmëria vlerësohet dhe të gjithë kanë mundësi të barabarta për të kontribuar në suksesin e biznesit dhe për të realizuar potencialin e tyre.

Punonjësit dhe persona të tjerë të përfshirë në veprimtaritë e Statkraftit do të trajtohen në një mënyrë që nuk diskriminon për sa i përket gjinisë, racës, fesë, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, kombësisë, origjinës sociale ose etnike, opinionit politik, përkatësisë sindikaliste ose ndonjë arsye tjetër. Nuk tolerojmë asnjë formë diskriminimi ose ngacmimi, përfshirë ngacmimin seksual, në asnjë nga vendet tona të punës. Do të sigurojmë pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë.

Kuptimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes

Veprimi në mënyrë të përgjegjshme

Handling cases of doubt and breaches of the rules

- **Blerja e shërbimeve seksuale**

Statkraft mbështet ndalimin e blerjes së shërbimeve seksuale. Asnjë shërbim seksual nuk duhet të blihet kur jeni në detyrë ose udhëtime pune për Statkraftin.

- **Informacioni dhe sistemet e TI**

Trajtojmë dhe përdorim informacionin, sistemet e TI dhe internetin në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale.

Informacioni i prodhuar dhe i ruajtur në sistemet e TI të Statkraftit konsiderohet si pronë e Statkraftit. Prandaj, Statkrafti rezervon të drejtën për të pasur akses në të gjithë këtë informacion, përveç rasteve kur kufizohet me ligj ose marrëveshje.

- **Mbrojtja e pronës dhe pasurive**

Jemi përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e duhur të pasurive të Statkraftit. Pasuritë e Statkraftit nuk mund të përdoren për përfitim personal.

Pjesa III: Trajtimi i rasteve të dyshimeve dhe shkeljeve të rregullave

1. Ku të kërkonti këshilla

Nëse ndonjë punonjës i Statkraftit është ose bëhet i pasigurt për kuptimin e ndonjë pjese të Kodit të Sjelljes ose për mënyrën e duhur të veprimit në përputhje me të, punonjësi në fjalë duhet të kërkojë këshilla dhe ta ngrejë çështjen me përgjegjësin e tij ose të saj.

2. Ku të raportoni shqetësime ose shkelje të rregullave

Nëse një punonjës i Statkraftit dyshon se një vendim ose veprim do të shkelë ose shkel angazhimet ligjore ose etike të Statkraftit, ai ose ajo ka të drejtë dhe përgjegjësi të ngrejë çështjen. Ai ose ajo duhet të kontaktojë menjëherë përgjegjësin e tij ose të saj. Aty ku kjo nuk është e mundur ose e vështirë, ai ose ajo duhet të kontaktojë Drejtuesin e Auditit të Korporatës (Head of Corporate Audit).

Të gjitha njoftimet do të trajtohen si informacion konfidencial. Njoftimi mund të bëhet në mënyrë anonime te Kanali i njoftimit të pavarur (Sinjalizimi) i menaxhuar nga Drejtuesi i Auditit të Korporatës (<https://statkraft.whistleblownetwork.net>). Përndryshe, me email, postë ose telefon direkt te Drejtuesi i Auditit të Korporatës (email: compliance@statkraft.com; telefon: +47 24 06 86 76; adresa: Statkraft AS, Head of Corporate Audit, P.O. Box 200 Lilleaker, NO-0216 Oslo, Norway).

Kanale të tjera të ankesave dhe/ose kërkesa për njoftim mund të ekzistojnë bazuar në legjislacionin vendas në fuqi.

Palët e jashtme, përfshirë personelin e punësuar, konsulentët dhe furnizuesit e tjerë, mund të njoftojnë gjithashtu shqetësime.

Statkrafti nuk do të ndërmarrë asnjë masë hakmarrëse kundër personave që ngrenë apo ndihmonjnë në trajtimin e sinkertë të një shqetësimi të integritetit të biznesit.

Kuptimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes

Veprimi në mënyrë të përgjegjshme

Handling cases of doubt and breaches of the rules

3. Pasojat e shkeljes

Mosrespektimi i Kodit të Sjelljes së Statkraftit konsiderohet si çështje serioze që mund të çojë në masa disiplinore duke përfshirë shkarkim, padi civile dhe mund t'u njoftohet autoriteteve përkatëse.

